

K O N T R A T E

PER KRIJIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"KONSTRUKSION" SH.P.K.

E hartuar sot, me datë .1.1994 ne Tiranë, nga
ortakët:

- 1.Koço Kondili i biri i Stavrit, lindur më 1955 në Korçë dhe banues po aty.
- 2.Zhuljeta Dako, e bija e Mihalit, lindur më 1956 në Korçë dhe banues po aty.
- 3.Frederik Kamburi, i biri i Arqiles, lindur më 1958 në Korçë dhe banues po aty.
- 4.Roza Terova e bija e Jorgaqit, lindur më 1959 në Korçë dhe banues po aty.
- 5.Lida Kushe, e bija e Selajdinit, lindur më 1955 në Korçë dhe banuese po aty.
- 6.Ilia Bode, i biri i Theodorit, lindur më 1950 në Korçë dhe banues po aty.

Kjo Kontratë u përpilua nga ortakët e lartpërmëndur , të cilët në mbështetje të ligjës Nr.7512 datë 10.8.1991 dhe ligjit nr. 7638 dt 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" vëndosën, për të krijuar këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 1

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar emërtuar "konstruksion" SH.P.K. me drejtues Asamblenë e Ortakëve të lartpërmëndur. Shoqëria do ta ketë qendrën e zyrës kryesore në Korçë me adresë rruga 1 Maj, nr. , dhe do të ushtrojë aktivitetin e saj në Tiranë në rrethe dhe jashtë vëndit, duke krijuar atje edhe filialet e saj sipas rastit.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë "konstruksion" SH.P.K. do të jetë:

Eksport-Import i lëndëve të para, materjaleve të çdo lloji përfshirë artikuj ushqimore, bujqësorë, industrialë farmaceutikë, pjesë këmbimi paisje e makineri, karburante e lëndë të para; në transportin tokesor, detar, ajror; në fushën e Turizmit, hotelërisë dhe ushqimit social; në prodhim dhe shërbime komunale, industri, ndërtim, infrastrukturë; në fushën bankare, e financiare, kambizëm, si dhe investime në to. Në ndërtim do të jenë këto drejtime kryesore :Ndërtime objektësh, kantiere etj.Ndërtime publike civile , turistike, shëndetsore kulturore, tregtare objekte sportive në teritor të Shqipërisë e jashtë saj. Hartim - projektim preventivash për vepra të ndryshme industriale publike kulturore shëndetsore etj.Blerje, shitje dhënie me qera objekteve turistike etj. Marje dhënie me qera të mjediseve tereneve ndërtimi etj.Kryerja e të gjithave punimeve projektuese , preventivuese, konstruksioni dhe ndërtimi për çfarëdo madhësie.

Neni 3

Kapitali fillestar i Shoqërisë do të jetë 6 373 134 lekë, i cili është egzistues si pasuri e patundëshme dhe në likuiditet. Kjo vleftë përbëhet nga kantjeri, nyja llaçit, makineritë dhe zyrat etj. Pjesmarrja e Ortakëve në këtë kapital do të jetë e barabartë me 1/6 pjesë secili.

Fondi i Shoqërisë do të shtohet çdo vit në funksion të aktivitetit të Shoqërisë e të zgjerimit të veprimtarisë së saj, investimeve të reja etj.

Shoqërija është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj, në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së saj.

Shoqërija mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale, përfshirë të drejtën për të afruar pasurit e saj dhe për të marrë kredi bankare.

Neni 4

Shoqëria përgjigjet për detyrimet e saj me fondet e veta. Fondet e nevojshme dhe përdorimi i tyre për këtë qëllim janë kompetencë e Asamblesë së Ortakëve.

Shoqëria a disponon edhe një sasi volute të konvertueshme e cila është shprehur në lekë.

Neni 5

Fitimi neto që do të realizohet nga veprimtaria e kësaj Shoqërije do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me kapitalin e tyre në këtë Shoqëri.

Për ushtrimin e veprimtarisë së saj Shoqëria do të aktivizojë specialistë, blerës dhe shitës si dhe personel administrativ në përputhje me mundësitë ekonomike, ligjet në fuqi dhe gjithmonë në marrveshje dhe me kontratë me ato që do të punësohen.

Mardhënjet që do të lindin me punonjësit që do të aktivizohen do të rregullohen me kontratën e punës.

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë këtijë aktiviteti të kësaj Shoqërije, përgjegjësi e saj shtrihet vetëm tek kapitali i saj. Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi për detyrimet e Shoqërisë me pasurinë e tyre që nuk bën pjesë në kapitalin e kësaj Shoqërije.

Neni 6

Asambleja e ortakëve do të jetë organi drejtues dhe vendimor. Kjo Asamble cakton administratorin e Shoqërisë. Në mbledhjen e parë ajo caktoi si administrator dhe President të saj Z. Koço Kondili.

Neni 7

Shoqëria është pronë e ortakëve veprimtaria e saj rregullohet me këtë Kontratë, Statutin e saj dhe ligjën shqipëtare.

Largimi vullnetar ose i detyrueshëm i ndonjërit nga ortakët nuk i jep të drejtë atij të marrë pjesë në natyrë nga pasuria e

palujtshme e shoqërisë, një e drejtë e tillë do i takojë nëse numri i atyre që largohen përbën gjysmën e ortakëve

Nuk mund të hiqet dorë nga kjo KONTRATE në mënyrë të njëanëshme, pa pëlqimin e ortakëve të tjerë. Ortaku që dëshirin pjesën e tij në këtë shoqëri është i detyruar që ofertën e tij për shitje t'ja bëjë ortakëve të tjerë dhe nëse këta të fundit nuk pranojnë t'a blejnë ose nuk japin përgjigje brënda 30 ditëve, nga dita e bërjes së ofertës, i lind e drejta ortakut të disponoj pjesën e tij.

Ortaku që shkel detyrimet e tij dhe nga kjo shkelje Shoqërisë i shkaktohet një dëm, është i detyruar të shpërblejë dëmin.

Mosmarrveshjet që lindin midis Ortakëve ose midis tyre dhe të tretëve do të zgjidhen me mirkuptim. Në rast se zgjidhja në këtë rrugë nuk arrihet lind e drejta e drejtimit në gjykatë.

Gjykatë kompetente do të jetë ajo e Rrethit Tiranë.

Neni 8

Me rastin e shpërndarjes apo mbarimit, falimentimit të Shoqërisë, pas paraqitjes nga një grup pune i bilancit, kapitali i akumuluar si rezultat i veprimtarisë së Shoqërisë dhe i filialeve të saj do të shpërndahet në përputhje me proporcionet e investimeve në kapitalin bazë dhe kjo pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet.

Neni 9

Dispozita më të hollësishme pasqyrohen në Statutin e Shoqërisë e cila i bashkangjitet kësaj Kontrate.

Neni 10


Kjo Kontratë hyn në fuqi me rregjistrimin e Shoqërisë në Gjykatë dhe seksionin financiar përkatës.

Neni 11

Kjo Kontratë ka fuqi mbi 10 vjet. Ajo mund të zgjatet me dëshirën e palëve ose mund të shkurtohet sipas përcaktimeve ligjore.

ORTAKET

1. Koço Kondili



2. Zhuljeta Dako, 3. Frederik Kamburi,

4. Roza Terova



5. Lida Kushe.



6. Ilia Bode,



STATUT

I SHOQERISE ME PËRGJEGJESI TE
KUFIZUAR "konstruksion" SH.P.K.

K R E U I

Neni 1

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "konstruksion"
SH.P.K. krijohet, me datë ne Korçë, nga ortakët e saj :

- 1.Koço Kondili i biri i Stavrit, lindur më 1955 në Korçë dhe banues po aty.
- 2.Zhuljeta Dako, e bija e Mihalit, lindur më 1956 në Korçë dhe banues po aty.
- 3.Frederik Kamburi, i biri i Arqiles, lindur më 1958 në Korçë dhe banues po aty.
- 4.Roza Terova e bija e Jorgaqit, lindur më 1959 në Korçë dhe banues po aty.
- 5.Lida Kushe, e bija e Selajdinit, lindur më 1955 në Korçë dhe banuese po aty.
- 6.Ilia Bode, i biri i Theodorit, lindur më 1950 në Korçë dhe banues po aty.

Ky Statut u përpilua nga ortakët e lartpërmëndur , të cilët në mbështetje të ligjës Nr.7512 datë 10.8.1991 si dhe ligjës Nr.7638 dt.19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" vendosën, për të zhvilluar aktivitet privat ekonomik - tregtar në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

Në këtë Shoqëri të krijuar në bazë të investimeve të dy ortakëve me 50 % secili, do të zhvillohet aktivitet i gjërë tregtar, import eksport dhe investime në Tiranë e në rrethe të tjera të vëndit, në bazë të marrvshjeve e bashkëpunimit me Shoqëri e Ndermarrje të tjera të vëndit e të huaja.

Drejtues administrativ të kësaj Shoqërije Asambleja e Ortakëve vendosi të jetë Koçë Kondili.

Neni 2

Krijohet Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar në formën e ortakërisë emërtuar "konstruksion" SH.P.K.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së "konstruksion" SH.P.K. do të jetë ai që përcaktohet në Kontratën midis ortakëve.

Neni 4

Shoqëria "konstruksion" SH.P.K. është person juridik, e drejtë kjo që fitohet nga dita e regjistrimit të saj në gjykatë.

Kjo SH.P.K. gëzon të gjitha të drejtat që gëzojnë personat e tjerë juridik shqiptar dhe garanton mbrojtjen e pasurive të sajë në përputhje të plotë me legjislacionin e vëndit, Kontratën dhe këtë Statut.

Kjo Shoqëri u krijua për të ushtruar veprimtarinë e saj për një kohë zgjatje prej 10 vjetësh. Ajo mund ta zgjasë afatin e veprimtarisë ose ta mbyllë aktivitetin para këtij afati, sipas dispozitave e kriterëve ligjore.

K R E U II

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 6373 134 lekë. Ky kapital themeltar zotërohet nga ortakët në mënyrë të barabartë secili. Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij janë të transferueshme si ndërmjet ortakëve ashtu edhe përkundrejt personave të tretë. Transferimi i kapitalit ose pjesëve të tij ndërmjet ortakëve ose në favor të një personi të tretë bëhet gjithmone me miratimin unanimit të gjithë ortakëve dhe me akt noterial. Të gjitha veprimet e Shoqërisë mbi kapitalin themeltar bëhen me miratimin e të gjithë ortakëve. Vlerësimi i kapitalit themeltar në natyrë bëhet nga ortakët në një marveshje të veçantë ose nga një ekspert kompetent i caktuar nga ortakët.

Neni 6

Zmadhimi ose zvoglimi i kapitalit themeltar në tërsi ose veçanti për një ose disa ortakë bëhet me vendim unanimit të të gjithë ortakëve. Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen në një regjistër të veçantë.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit të sajë, SH.P.K. krijon fondin rezervë, fondet e tjera financiare të veçanta për zhvillimin e sajë, nxitjen ekonomike, gumbullimin e vulltës etj.

Përbërja, shuma e përgjithëshme, burimet e krijimit të këtyre fondeve, përdorimi dhe rregullimi i tyre si dhe çdo aspekt tjetër që ka të bëjë me to zgjidhen në bazë të ligjës dhe vullnetin e dy Ortakëve.

Neni 7

Detyrimet e "KONSTRUKSION "SH.P.K që do të lindin gjatë aktivitetit të saj me të tretët, mbulohe vetëm me pasurinë e saj. Ortakët e kësaj Shoqërie nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasuritë e tyre që nuk janë futur në kapitalin e kësaj Shoqërie.

Neni 8

Aktiviteti ekonomik i Shoqërisë pasqyrohet në bilancet financiare të cilat përpilohen tremujore dhe vjetore. Format e këtyre bilanceve si dhe afatet e mënyra e plotësimit të tyre caktohen nga Asambleja e Ortakëve në përputhje me praktikën e personave të tjerë juridik të ngjashëm me të, si dhe udhëzimet e ligjet në fuqi.

Neni 9

Fitimi neto i realizuar nga aktiviteti i Shoqërisë do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me pjesët e tyre përkatëse në kapitalin themelor.

Drejtimet kryesore të punës për realizimin e këtijë aktiviteti janë:

- Studimi i tregut për nevojat materjale të personave fizikë dhe juridikë privat dhe shtetëror.

- Evidentimi i kërkesave nga studimi i mësipërm, sigurimi i tyre dhe furnizimi me to i porositësve.

Fusha e aktivitetit tregtar të Shoqërisë në drejtim të eksportit do të jetë :

- Eksportimi i produkteve të çdo lloji dhe fushe.

Fusha e aktivitetit të ndërmarrjes në drejtim të importit do të jetë i pa kufi duke përfshirë çdo material, mall e objekt që paraqet interes për Shoqërinë.

K R E U III

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

Neni 10

Ortakët kanë të drejtat dhe detyrat kryesore në Shoqëri të cilat ushtrohen nëpërmjet vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve.

Ortakët kanë këto të drejta kryesore:

- Administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë, në përputhje me Statutin dhe Kontratën.

- Realizimin dhe përfitimin nga rezultatet e çdo forme e sasi të veprimtarisë së Shoqërisë së parashikuar në Statutin dhe Kontratën e saj.

- Marrjen e informacionit të plotë për aktivitetin e Shoqërisë.

- Heqjen dorë nga vazhdimësija e punës së Shoqërisë në format e parashikuara nga ligja. Në këtë rast partneri që heq dorë detyrohet të njoftojë partnerin tjetër 3 muaj më parë.

Neni 11

Detyrimet kryesore të ortakëve janë:

- Të interesohet dhe ushtroj kontroll për të kryer shitjet dhe blerjet në një kohë sa më të shkurtër, duke patur parasysh derdhjen në kohën e duhur të të ardhurave në llogarinë rrjedhëse të Shoqërisë.

- Të respektoj ligjën, kontratën dhe statutin. Për çdo veprim të kundërt e të njëanshëm personi përgjegjës detyrohet sipas parashikimeve ligjore e dokumentacionit të Shoqërisë.

- Të dorzojnë kuotën e tyre ose kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe me vendimet e Asamblesë.

- Të marrin pjesë në administrimin e Shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga ata vetë.

- Të kryejnë detyrimet e ngarkuara nga Asambleja ose Ad-

ministratori, për realizimin e detyrave të Shoqërisë.

K R E U I V

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË

Neni 12

Organi më i lartë vendimor i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

Në Asamble marrin pjesë të gjithë ortakët me të drejtë vote sipas shumave të vëna në kapitalin themelor të firmës.

Asambleja e ortakëve vendos për këto probleme :

Miraton bilancin vjetor të firmës.

Vendos për shtimin, pakësimin ose transferimin e kapitalit themelor.

Emëron dhe shkarkon Administratorin e Shoqërisë.

Bën modifikimin në KONTRAT dhe STATUT sipas ecurive të shoqërisë.

Unanimiteti në vendimet e Asamblesë është i domosdoshëm për këto çështje :

Për modifikimin e KONTRATES dhe STATUTIT.

Për rritjen, pakësimin ose transferimin e kapitalit themeltar dhe për mbylljen e shoqërisë.

Për çështje të tjera Asambleja vendos me shumicë votash.

Asambleja e Ortakëve thihet jo më pak se një herë në vit.

Neni 13

Administratori i Shoqërisë ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër dhe për llogari të Shoqërisë në marrëdhëniet me personat e tretë.

Administratori nuk mund të kryejë vetëm ato detyra që i janë lënë për kompetencë Asamblesë të Ortakëve.

Shoqëria merr përsipër të gjitha pasojat që mund të vijnë nga veprimet e Administratorit.

Neni 14

Administratorët janë përgjegjës individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose ndaj personave të tretë, kur gjatë veprimeve të tyre shkelin ligjin, kontratën dhe statutin, aktet e Asamblesë ose për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtën e përfaqësimit të Shoqërisë në të gjitha rastet e nevojëshme, dhe janë fuqiptotë në marrjen e përgjegjësive dhe sigurimin e fitimeve, brënda kuadrit ligjor të kësaj Shoqërije. Përgjegjësjia për humbje të rezultuara nga veprime të njëanëshme bie mbi personin që i kryen ato.

Neni 15

Vendosja e çmimeve është detyrë dhe e drejtë ekskluzive e Ortakëve. Çdo veprim i kundërt ka pasojat e shkeljeve financiare të parashikuara nga ligja. Në vendosjen e tyre ndiqen kriteret e

përcaktuara në ligjën 7512 datë 10.8.1991 të Kuvëndit Popullor.
dhe ligjës nr.7638 dt.19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare"

Neni 16

Shoqërija i siguron mallrat dhe i tregton ato nëpërmjet kontratave me sektorët shtetëror, privat si dhe persona fizik e juridik vëndas e të huaj, sipas legjislacionit në fuqi për eksport importin brënda dhe jashtë vëndit.

Neni 17

Shoqërija mban kontabilitet të rregullt dhe ka të drejtë të çeli llogari pranë bankave të vëndit e të huaja në Shqipëri dhe të kryej veprimet e likuidimit nëpërmjet tyre.

Neni 18

Bilanci vjetor sëbashku me deklaraten e të ardhurave të humbjeve e fitimeve, hartohet nga Këshilli i Ortakëve dhe depozitohet në Zyrën e Taksave sipas afateve ligjore.

Neni 19

Për punësimin dhe largimin e punëtorve dhe nëpunësve veprohet në bazë të kontratës së punës. Në të janë evidentuar të drejtat dhe detyrat e punëdhënësit dhe punëmarrësit. Për problemet e mardhënjeve të punës të paparashikuara nga kontrata zbatohen ligjet e punës.

Neni 20

Shoqërija ka të drejtë të marri kredi në lekë dhe volutë nga Banka e Shtetit Shqiptar ose nga bankat e tjera, shtetërore a private, vëndase a të huaja.

Kjo Shoqëri ka gjithashtu të drejtë të vetfinancohet në lekë ose volutë të huaj.

Shkëmbimi i monedhës shqiptare me monedhë të huaj dhe anasjelltas bëhet nga perfaqësuesit e Shoqërisë në përputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose në tregun e lirë privat të valutave.

K R E U V

MBYLLJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE

Neni 21

Veprimtaria e Shoqërisë pushon në rastet e parashikuara nga ligji. Mënyra dhe të drejtat e largimit janë ato që janë përcaktuar në KONTRATE. Shoqërija mund të pushojë veprimtarinë e saj edhe para afatit të parashikuar në KONTRAT nëqoftëse ortakët me vullnetin e tyre të lirë nuk e zgjatin këtë afat, ose ortakët marri vendim për pushimin e saj. Veprimtaria e Shoqërisë pushon edhe në ato raste kur ortakët vendosin shndrimin e saj nga SH.P.K. në një lloj Shoqërije tjetër.

Neni 22

Kur Shoqëria pushon aktivitetin e saj, Asambleja krijon komisionin e Likuidimit i cili paraqet bilancin e likuidimit. Asambleja pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të ardhurave e disponon në funksion të detyrimeve dhe lejitimeve ligjore, si dhe të drejtave të pronësisë.

Neni 23

Pasurija që është futur në Shoqëri me të drejtë shfrytëzimi i kthehet pronarit të saj.

Neni 24


Ky Statut hyn në fuqi me rregjistrimin e Shoqërisë në Gjykatën e Rrethit dhe Zyrën përkatëse të Tatimeve. Për ushtrimin e aktivitetit në rrethe të tjera të vëndit në mbështetje të ligjës 7512 dt. 10.8.1991 Ndërmarrja bën regjistrimin në seksionin përkatës.

Neni 25

Aktiviteti i Shoqërisë Tregtare "KONSTRUKSION" SH.P.K. u vendos që të jetë mbi 10 vjet.

O R T A K E T

KOÇI KONDILI




ROZA TEROVA



ZHULIETA DAKO

LIDA KUSHE



FREDERIK KAMBURI

ILIA BODE

